Shoqëria koncesionare Porti MBM (Multi Buoy Mooring)
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021
Së bashku me raportin e audituesit të pavarur

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	i – ii
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7 – 27

Emin Duraku Str. Binjaket Build.
No.5, 1009, Tirana
Albania
Tel: +355 4 2222 889
www.mazars.al

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe Aksionerëve të shoqërisë "Porti MBM (Multi Buoy Mooring)"

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale ("Pasqyrat financiare") të Shoqërisë **"Porti MBM (Multi Buoy Mooring)"** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2021, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2021, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale perveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e proçesit të raportimit financiar të Shoqërisë

mazars

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.
Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë proçedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për proçesin e auditimit me qëllim hartimin e proçedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, perveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

15 shtator 2022

mazars
Emin Duraku Str., Binjaket Build.,
No.5, 1013, Tirana, Albania
NUIS: K32123006W

Irena Hoxha (Pulo)
Auditues Ligjor

Pasqyra e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2021

	Shënime	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
AKTIVE			
Aktivet afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	6	980,272,651	41,532,297
Aktivet afatgjata jomateriale me koncension	7	4,876,858,336	2,580,392,342
Paradhënie për ndërtime	9	158,208,319	113,648,496
Aktivet afatgjata jomateriale	8	146,240	158,756
Totali i aktiveve afatgjata		**6,015,485,546**	**2,735,731,891**
Aktivet afatshkurtra			
Inventarë	10	6,914,715	43,428
Llogari të arkëtueshme tregtare	11	15,749,561	17,044,468
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	12	45,855,250	102,814,983
Llogari të arkëtueshme të tjera	13	278,413,802	341,964,567
Mjetet monetare në arkë e në bankë	14	23,463,953	9,537,500
Totali i aktiveve afatshkurtra		**370,397,281**	**471,404,946**
Totali i aktiveve		**6,385,882,827**	**3,207,136,837**
KAPITALI			
Kapitali aksionar/themeltar		100	100
Kapital i papaguar		(100)	(100)
Fitime të mbartura		451,418,053	201,343,054
Fitimi i ushtrimit		273,738,556	250,074,999
Totali i kapitalit	**15**	**725,156,609**	**451,418,053**
DETYRIMET			
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	16	3,741,673,213	2,020,333,437
Të tjera afatgjata		185,483,704	27,594,437
Totali i detyrimeve afatgjata		**3,927,156,917**	**2,047,927,874**
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	16	785,889	-
Llogari të pagueshme tregtare	17	518,263,402	93,852,636
Llogari të pagueshme nga palët e lidhura	18	1,198,325,654	592,142,825
Tatim fitimi	19	7,454,912	18,460,956
Detyrime tatimore	20	8,168,302	2,333,771
Llogari të pagueshme të tjera	21	571,142	1,000,722
Totali i detyrimeve afatshkurtra		**1,733,569,301**	**707,790,910**
Totali i detyrimeve		**5,660,726,218**	**2,755,718,784**
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		**6,385,882,827**	**3,207,136,837**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Fitimit ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	22	663,413,298	565,470,144
Të ardhura nga aktiviteti i ndërtimit sipas IFRIC 12	23	-	528,478,973
Të ardhura të tjera	22	86,721,434	25,344,168
Total të ardhura		**750,134,732**	**1,119,293,285**
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	24	(69,231,189)	(558,193,532)
Shpenzime personeli	25	(71,929,109)	(54,305,872)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	6,7,8	(110,083,800)	(69,827,348)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	26	(103,554,833)	(53,761,213)
Total shpenzime		**(354,798,931)**	**(736,087,965)**
Shpenzime interesi dhe të ngjashme (neto)	27	(103,959,801)	(72,880,698)
Shpenzime të tjera financiare (neto)	27	33,353,144	(14,395,296)
Fitimi/humbja para tatimit		**324,729,144**	**295,929,326**
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	**28**	**(50,990,588)**	**(45,854,327)**
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(50,990,588)	(45,854,327)
Fitimi/humbja e vitit		**273,738,556**	**250,074,999**
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		**-**	**-**
Diferencat (+/-) nga perkthimi i monedhes ne veprimtari te huaja		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin			**-**
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		**273,738,556**	**250,074,999**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Kapitali i nënshkruar	Kapital I papaguar	Fitimet e Pashpërndara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 01 janar 2020	**100**	**(100)**	**(16,656,242)**	**217,999,296**	**201,343,054**
Fitim/humbja për vitin:	-	-	-	250,074,999	250,074,999
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	217,999,296	(217,999,296)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	**100**	**(100)**	**201,343,054**	**250,074,999**	**451,418,053**
Fitim/humbja për vitin:	-	-	-	273,738,556	273,738,556
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:	-	-	250,074,999	(250,074,999)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2021	**100**	**(100)**	**451,418,053**	**273,738,556**	**725,156,609**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 janë aprovuar nga administratori i Shoqërisë koçesionare Porti MBM (Multi Buoy Mooring) dhe janë firmosur si më poshtë:

Ahmet Kastrati
Administrator

Amarildo Almuca
Drejtor Finance

Pasqyra e Flukseve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit		324,729,144	250,074,999
Axhustime për zërat jo-monetare:			
Zhvleresim dhe amortizimi		95,053,689	69,827,348
Dalje te aktiveve		8,160,135	-
Interesa te maturuara ne rezultat		-	72,880,698
Ndryshimi ne kapitalin qarkullues			
Rënie/(rritje) në inventar		(6,871,287)	(43,426)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera		121,805,405	(38,728,155)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera		1,128,035,552	35,494,240
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative		**1,670,912,638**	**389,505,704**
Interesa të paguara		(103,043,050)	(72,880,698)
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit		(50,990,588)	(56,417,866)
Mjetet monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet operative		**(154,033,638)**	**(129,298,564)**
Aktivitetet investuese			
Paradhenie per ndertime		(44,559,823)	(105,539,162)
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale		(3,338,407,656)	(555,296,352)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues		**(3,382,967,479)**	**(660,835,514)**
Aktivitetet financuese			
Ripagim / disbursim i huave afatgjata		1,880,014,932	384,641,792
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues		**1,880,014,932**	**384,641,792**
Ndryshimi neto i mjeteve monetare		13,926,453	(15,986,582)
Mjetet monetare në fillim të periudhës		9,537,500	25,524,082
Mjetet monetare në fund të periudhës		**23,463,953**	**9,537,500**

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 27, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria konçesionare Porti MBM (Multi Buoy Mooring),("Shoqëria") është themeluar dhe e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar. Shoqëria është regjistruar në datën 21 prill 2015 në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), me NIPT L51621501S.

Aktiviteti kryesor i shoqërisë janë shërbimet portuale, për shkarkimin e anijeve të hidrokarbureve.

Kapitali i shoqërisë është 100 lekë dhe zotërohet në masën 99% nga Adriatic Bay Investment Group dhe 1% nga Salillari shpk.

Adresa e regjistruar e Shoqërisë është: Porto Romano, Durrës.

Shoqëria është organizuar në formën e një shoqërie të thjeshtë. Ajo operon në bazë të Ligjit Nr. 104/2015 dhe Ligjit Nr. 13/2019 sipas të cilit është miratuar kontrata e koncesionit e formes BOT për portin e llojit MBM nëpërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë konçesionare Porti MBM. Termat kryesore të kontratës së koncesionit pas amendimit janë si më poshtë: Kontrata fillon me datë 28.10.2015 dhe afati është 35 vite. Vlera totale parashikuar e investimit është 14.5 milion USD me detyrimin riinvestimi në vitin e pestë nga fundi i kontratës të shumës prej 40% të vlerës së investimit.

Numri i punonjesve me 31 dhjetor 2021 ishte 159 (31 dhjetor 2020: 64).

2. Bazat e përgatitjes

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4 Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

2. Bazat e përgatitjes (vazhdim)

2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar kërkon që Drejtimi të bëjë gjykimet, vlerësimet dhe supozimet të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të ndryshojnë si pasojë e këtyre vlerësimeve.
Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Informacionet në lidhje me zonat e rëndësishme të vlerësimit të pasigurisë dhe gjykimit kritik në aplikimin e politikave kontabël të cilat më së shumti ndikojnë në paraqitjen e shumave në pasqyrat financiare, janë paraqitur në shënimin nr. 5.

3. APLIKIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA (SNRF)

3.1 Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet e amenduara më poshtë janë bërë efektive për kompaninë nga 1 janar 2021, por nuk kanë pasur asnjë impakt material në kompani:

Konçensione të lidhura me qiratë në kushtet e COVID-19 përtej 30 qershor 2021 (Ndryshime në SNRF 16)
Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7) Faza 2.

3.2 Standardet dhe interpretime të lëshuara, por që ende nuk janë adoptuar

Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit ka lëshuar disa standarde dhe interpretime që janë efektive me periudhat e ardhshme kontabël, të cilat kompania ka vendosur mos t'i aplikojë paraprakisht. Kompania planifikon t'i aplikojë këto standarde dhe interpretime kur ato të bëhen efektive.
Standardet dhe interpretimet e mëposhtme janë lëshuar por nuk janë të detyrueshme për periudhën aktuale të raportimit të mbyllur më 31 dhjetor 2021:

- Kontratat me kushte – Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37) – Në fuqi nga 1 janari 2022
- Aktive afatgjatë materiale: Të ardhurat përpara përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16) - Në fuqi nga 1 janari 2022
- Përmirësimet Vjetore të Standardeve SNRF 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16 dhe SNK 41) - Në fuqi nga 1 janari 2022
- Referencat në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3). Në fuqi nga 1 janari 2022
- Dhënia e shënimeve shpjeguese të politikave kontabël (Ndryshimet në SNK 1 dhe Deklarata e Praktikës IFRS 2) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- Tatimi i shtyrë në lidhje me aktivet dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm (Ndryshimet në SNK 12) - Në fuqi nga 1 janari 2023
- SNRF 17 – Kontratat e Sigurimeve – Në fuqi më 1 janar 2023

4. Politika të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në të gjitha periudhat e pasqyruara në këto pasqyra financiare dhe në mënyrë të vazhdueshme nga shoqëria.

4.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
EUR/LEK	120.76	123.70
USD/LEK	106.54	100.84

4.2 Instrumenta financiarë

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në dispozitat kontraktuale të instrumentit.

Instrumentat financiare – njohja fillestare. Instrumentet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (VDNFH) fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë. Të gjithë instrumentet e tjerë financiarë fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Vlera e drejtë në njohjen fillestare përcaktohet më së miri nga çmimi i transaksionit. Pas njohjes fillestare, një humbje e pritshme e kredisë (HPK) njihet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar (KA) dhe investimet në instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDATGJ), duke rezultuar në një humbje kontabël të menjëhershme.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – kategoritë e matjes. Kompania klasifikon aktivet financiare në kategoritë e mëposhtme të matjes: VDNFH, VDATGJ dhe KA. Klasifikimi dhe matja pasuese e aktiveve financiare të borxhit varet nga: (i) modeli i biznesit i kompanisë për menaxhimin e portofolit të aktiveve të lidhura dhe (ii) karakteristikat e fluksit të mjeteve monetare të aktivit.

Aktive financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – modeli i biznesit. Modeli i biznesit pasqyron mënyrën se si Kompania menaxhon pasuritë në mënyrë që të gjenerojë flukse monetare - nëse objektivi i Kompanisë është: (i) vetëm për të mbledhur flukse monetare kontraktuale nga aktivet ("mbajtur për të mbledhur flukse monetare kontraktuale") ose (ii) për të mbledhur të dyja flukset e mjeteve monetare kontraktuale dhe flukset e mjeteve monetare që rrjedhin nga shitja e aktiveve ("duke arkëtuar flukse mjetesh monetare kontraktuale ashtu dhe duke shitur aktive financiare") ose, nëse asnjë nga (i) dhe (ii) nuk aplikohet, si pjesë e modelit të biznesit "të tjerë" dhe të matur në VDNFH.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Modeli i biznesit përcaktohet për aktivet individuale financiare (në nivel individual) bazuar në të gjitha dëshmitë përkatëse për aktivitetet që Kompania ndërmerr për të arritur objektivin e caktuar për aktivin në dispozicion në datën e vlerësimit. Faktorët që konsiderohen nga kompania në përcaktimin e modelit të biznesit përfshijnë: qëllimin e aktivit, përvojën e kaluar në mënyrën se si janë arkëtuar flukset e mjeteve monetare për aktivet përkatëse, si vlerësohen dhe menaxhohen rreziqet, si vlerësohet performanca e aktiveve dhe si menaxherët kompensohen.

Aktivet financiare – klasifikimi dhe matjet pasuese – karakteristikat e fluskeve monetare. Kur modeli i biznesit është mbajtja e aktiveve për të mbledhur flukse monetare kontraktuale ose për të mbajtur flukse monetare kontraktuale dhe për ti shitur, kompania vlerëson nëse flukset e mjeteve monetare përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit ("VPPI"). Gjatë marrjes së këtij vlerësimi, kompania konsideron nëse flukset monetare kontraktuale janë në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, pra interesi përfshin vetëm konsideratën për rrezikun e kredisë, vlerën në kohë të parasë, rreziqet e tjera të huadhënies dhe marzhin e fitimit. Kur kushtet kontraktuale paraqesin ekspozim ndaj rrezikut ose paqëndrueshmërisë që nuk është në përputhje me një marrëveshje bazë huadhënie, aktivi financiar klasifikohet dhe matet në VDNFH. Vlerësimi i VPPI kryhet në njohjen fillestare të një aktivi dhe nuk rivlerësohet më pas. Referojuni Shënimit 5 për gjykimet kritike të aplikuara nga Kompania në kryerjen e provës VPPI për asetet e saj financiare.

Aktivet financiare – pakësimi i vlerës. Shoqëria do të pakësojë vlerën bruto të mbartur të një aktivi financiar kur njësia ekonomike në mënyrë të arsyeshme nuk pret të rikuperojë vlerën e plotë apo një pjesë të këtij aktivi financiar. Pakësimi i vlerës përfaqëson një ngjarje çregjistrimi. Treguesit që nuk ka parashikime të arsyeshme të rimëkëmbjes përfshijnë shkelje të kushteve të kontratës si vonesa në pagesa ose ngjarje të mos pagesës në kohë, paaftësi paguese dhe falimentim. Kompania mund të çvlerësojë aktivet financiare që ende i nënshtrohen veprimtarisë së zbatimit kur Kompania kërkon të rimarrë shumat që janë për pjesë e kontratës, megjithatë, nuk ka shpresa të arsyeshme për rimarrje.

Aktivet financiare - çregjistrimi. Shoqëria çregjistron aktivet financiare kur (a) përfundojnë të drejtat kontraktuale për flukset monetare nga aktivi financiar ose (b) kompania ka transferuar të drejtat për flukset e mjeteve monetare nga aktivet financiare ose kanë hyrë në një marrëveshje ku ruan të drejtat kontraktuale për të marrë flukset e mjeteve monetare të një aktivi financiar ("aktivi fillestar"), por merr përsipër një detyrim kontraktual për t'ua paguar këto flukse të mjeteve monetare një ose më shumë njësive ekonomike pra kur (i) transferon thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë të aktivit financiar, ose (ii) nuk ka ruajtur kontrollin dhe as nuk transferon, as nuk man thelbësisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar. Kontrolli ruhet në qoftë se pala tjetër nuk ka aftësinë praktike për të shitur asetin në tërësi tek një palë e tretë e palidhur pa pasur nevojë të vendosë kufizime shtesë për shitjen.

Detyrimet financiare – kategorite e matjes. Detyrimet financiare klasifikohen si të matura më pas me Koston e Amortizuar (KA), përveç (i) detyrimeve financiare të matur me VDNFH. Ky klasifikim zbatohet për derivativët, detyrimet financiare të mbajtura për tregtim (p.sh. pozicionet e shkurtra në letra me vlerë), shumës së kushtëzuar të njohur nga një blerës në një kombinim biznesi dhe detyrime të tjera financiare të përcaktuara si të tilla në njohjen fillestare dhe (ii) kontratat e garancisë financiare dhe angazhimet e huasë.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.2 Instrumenta financiarë (vazhdim)

Detyrimet financiare – çregjistrimi. Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato shuhen (dmth. Kur detyrimi i specifikuar në kontratë shkarkohet, anulohet ose skadon).

Kompensimi i instrumenteve financiare. Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe raportohet shuma neto në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë e detyrueshme ligjore për kompensimin e shumave të njohura dhe ka një qëllim që të shlyhet në baza neto ose të realizojë aktivin dhe zgjidhë detyrimin në të njëjtën kohë. Kjo e drejtë e kompensimit (a) nuk duhet të jetë e kushtëzuar nga një ngjarje e ardhshme dhe (b) duhet të jetë ligjërisht e zbatueshme në të gjitha rrethanat e mëposhtme: (i) në rrjedhën normale të biznesit, (ii) në rast vonese të pagesave dhe (iii) në rast të paaftësisë së pagesës ose falimentimit.

Kompania zotëron vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbërë nga llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe llogari të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, llogaritë e pagueshme tregtare dhe llogari të tjera, kreditë e tjera. Të gjitha instrumentet financiare fillimisht regjistrohen me vlerën e drejtë të rregulluar për kostot e transaksionit. Pas njohjes fillestare, instrumentet financiare të Kompanisë maten me koston e amortizuar.

Vlera e drejtë është shuma në të cilën një instrument financiar mund të këmbehet në një transaksion të tanishëm midis palëve të gatshme, përveçse në një shitje të detyruar ose likuidim, dhe dëshmohet më së miri nga një çmim aktiv i kuotuar i tregut. Vlera e drejtë e instrumenteve financiare që nuk tregtohen në një treg aktiv (asnjë nga aktivet financiare të Kompanisë nuk tregtohet në një treg aktiv) përcaktohet duke përdorur teknikat e vlerësimit. Në njohjen fillestare, vlera e drejtë e të gjitha aktiveve financiare vlerësohet të përafrohet me koston e tyre të transaksionit.
Kostoja e amortizuar është shuma në të cilën instrumenti financiar është njohur në momentin fillestar minus çdo ripagim të principalit, plus interesin e përllogaritur, dhe minus çdo kompensim për humbjet e pritura të kredisë për aktivet financiare.

4.3 Inventari

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.
Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

4.4 Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale janë matur me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi i akumuluar.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Kostot përfshijnë shpenzimet që janë të lidhura direkt me blerjen e aktivit. Kosto e aktivit të ndërtuar vetë përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe çdo kosto tjetër direkte të lidhur me vënien e aktivit në kushtet e punës për përdorimin e parashikuar, kostot e çmontimit dhe heqjen e pjesëve dhe restaurimin
e zonës në të cilat ato janë vendosur dhe kostot e huamarrjes së kapitalizuara. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.
Kur pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si zëra të ndara (pjesë të rëndësishme) të akteveve afatgjata materiale.
Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e ndonjë zëri të akteveve afatgjata materiale janë përcaktuar duke krahasuar të ardhurat e marra nga nxjerrja jashtë përdorimit me vlerën kontabël (neto) të akteveve afatgjata materiale dhe janë pasqyruar neto në të ardhura të tjera në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronave, makinerive dhe pajisjeve është njohur në vlerën kontabël (neto) të pjesës në qoftë se është e mundur që në të ardhmen të mirat ekonomike të përfshira në atë pjesë do t'i vijnë Shoqërisë dhe kostoja mund të matet me besueshmëri. Vlera kontabël (neto) e pjesës që zëvendësohet hiqet nga regjistrimet. Kostot e shërbimeve të përditshme të pronave, makinerive dhe pajisjeve janë të njohura në të ardhurat ose shpenzimet kur ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi është llogaritur mbi vlerën e amortizueshme, e cila është kostoja e aktivit duke zbritur vlerën e mbetur. Amortizimi njihet me normat si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Norma e Amortizimit
Toka	Nuk amortizohet
Ndërtesa, makineritë dhe paisjet objekt Koncensioni	10-30 vite
Mjetet e transportit	20% në bazë të vlerës së mbetur
Pajisje kompjuterike	25% në bazë të vlerës së mbetur
Pajisje zyre	20% në bazë të vlerës së mbetur

Këto norma reflektojnë më së shumti vlerën e pritshme të konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike që burojnë nga aktivet afatgjata materiale. Prodhimi në proçes nuk amortizohet.
Normat e amortizimit dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në çdo datë raportimi.

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.
Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.5 Aktivet me të drejtë përdorimi dhe qiratë financiare (SNRF 16)

Njësia ekonomike vlerëson nëse një kontratë është ose përmban një qira në fillim të kontratës. Një qira përmban të drejtën për të përftuar përdorimin dhe për të marrë në thelb të gjitha përfitimet ekonomike të një aktivi të identifikuar për një periudhë kohe në këmbim të flukseve dalëse.

Në datën e fillimit të qirasë, njësia ekonomike njeh një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe një detyrim qiraje në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike. Aktivi i së drejtës së përdorimit matet me kosto, i cili përbëhet nga matja fillestare e detyrimit të qirasë, çdo kosto fillestare direkte e kryer nga njësia ekonomike, një vlerësim i çdo kostoje për të çmontuar dhe hequr aktivin në fund të qirasë, dhe çdo pagesë qiraje e bërë para datës së fillimit të qirasë (neto nga çdo zbritje e marrë). Njësia ekonomike zhvlerëson të drejtën e përdorimit të aktivit mbi një bazë lineare nga data e fillimit të qirasë deri në më te hershmen midis fundit të jetës së dobishme të aktivit të së drejtës së përdorimit dhe afatit të qirasë. Njësia ekonomike gjithashtu zhvlerëson aktivin e së drejtës së përdorimit kur ekzistojnë tregues të tillë.

Në datën e fillimit, njësia ekonomike mat detyrimin e qirasë me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të papaguara në atë datë, e skontuar me normën shtesë të huamarrjes së njësisë ekonomike, pasi që kontratat e qirasë negociohen me palët e treta nuk është e mundur të përcaktohet norma e interesit që nënkuptohet në qira.

Norma rritëse e huamarrjes është norma e vlerësuar që njësia ekonomike duhet të paguajë për të marrë hua të njëjtën shumë gjatë një afati të ngjashëm, dhe me siguri të ngjashme për të marrë një aktiv me vlerë ekuivalente. Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përbëhen nga pagesa fikse (përfshirë në substancë fikse), pagesa të ndryshueshme bazuar në një indeks ose normë, shuma që pritet të paguhen nën një garanci të vlerës së mbetur dhe pagesa që vijnë nga opsionet të cilat kanë një bazë të arsyeshme që do të ushtrohen.

Pas matjes fillestare, pasivi do të zvogëlohet nga pagesat e qirasë që shpërndahen midis ripagimeve të principalit dhe kostove financiare. Kostoja financiare është shuma që prodhon një normë konstante periodike interesi në pjesën e mbetur të detyrimit të qirasë.

Çdo fitim ose humbje në lidhje me përfundimin e pjesshëm ose të plotë të qirasë njihet në fitim ose humbje. Aktivi i së drejtës së përdorimit rregullohet për të gjitha modifikimet e tjera të qirasë.

Njësia ekonomike ka zgjedhur të regjistrojë qira afatshkurtra dhe qira të aktiveve me vlerë të ulët duke përdorur përshtatjet praktike. Në vend që të njohim një pasuri të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë, pagesat në lidhje me to njihen si një shpenzim në fitim ose humbje mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

4.6 Kosto e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin të aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve. Kostot e huamarrjes kanë të bëjnë me interesin dhe kosto të tjera që janë bërë nga një shoqëri në lidhje me marrjen e fondeve.
Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.7 Të ardhurat

Shoqëria realizon të ardhura nga operimi i aktivitetit portual me palët e treta. Ajo i njeh të ardhurat në momentin e plotësimit të kushteve të performancës që lidhen me dhënien e shërbimeve portuale duke përdorur çmimet e aprovuara nga autoriteti kontraktues.

Të ardhurat nga ndërtimi që rrjedhin nga aplikimi i KIRFN 12 dhe SNFRF 15 njihen me vlerën e drejtë. Vlera e drejtë është çmimi që do të pranohej për të shitur një aktiv ose çmimi që do të paguhej për të transferuar një detyrim, në një transaksion të zakonshëm. Aktiviteti i ndërtimit të infrastrukturës është i nënkontraktuar, për këtë arsye vlera e drejtë e të ardhurave nga aktiviteti i ndërtimit është ajo e blerjes së shërbimeve të ndërtimit nga palët e treta.

4.8 Provizione

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.9 Trajtimi kontabël për marrëveshjen e koncesionit

Shoqëria ka aplikuar KIRFN 12 "Marrëveshjet koncesionare të shërbimeve" për njohjen e kontratës së koncensionit pasi koncesion dhënësi kontrollon ose rregullon se çfarë shërbimesh të infrastrukturës duhet të kryejë operatori, kujt duhet t'ia kryejë ato dhe me çfarë çmimi dhe koncesion dhënësi kontrollon çdo interes të konsiderueshëm të mbetur në infrastrukturë në fund të afatit të marrëveshjes.

Shërbimet e ndërtimit ose të përmirësimit janë njohur në përputhje me kërkesat e SNRF 15 me vlerën e tyre të drejtë. Nga ana tjeter shoqëria ka njohur një aktiv jomaterial në masën që i jep atij të drejtën (licencën) për t'i tarifuar përdoruesve të shërbimit publik. Një e drejtë për t'ia faturuar shpenzimet përdoruesve të shërbimit publik nuk është një e drejtë e pakushtëzuar për të arkëtuar mjete monetare, sepse shumat janë në varësi të shkallës së përdorimit të shërbimit nga publiku.

Shoqëria vazhdon akoma procesin e ndërtimit.

4.10 Përfitimet e punëmarrësve

Kontributet e detyrueshme shoqërore

Një plan i kontributit të përcaktuar është një plan përfitimi pas periudhës së punësimit sipas të cilit një njësi ekonomike paguan kontribute në shuma fikse në një entitet të veçantë dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor apo konstruktiv për të paguar shuma të mëtejshme. Qeveria e Shqipërisë është përgjegjëse për sigurimin e pensioneve në Shqipëri, sipas një plani të përcaktuar të kontributeve të pensionit. Kontributet e Shoqërisë në planin e përcaktuar të kontributeve të pensionit njihen si një shpenzimi i përfitimit të punonjësve në të ardhura dhe shpenzime në periudhat gjatë të cilave kryhen shërbimet nga të punësuarit.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

4.11 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.
Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.
Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.
Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

4.12 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

4.13 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

5. Gjykime dhe vlerësime kritike të kontabilitetit

Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe janë bazuar në eksperiencat historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe pritshmërinë për ngjarjet e ardhshme për të cilat besohet të jenë të arsyeshme në bazë të rrethanave.
Shoqëria bën vlerësime dhe supozime lidhur me të ardhmen. Rezultati i vlerësimeve kontabël, sipas përcaktimit, rrallë do të jetë i barabartë me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet të cilat kanë një risk të konsiderueshëm për shkaktimin e një sistemimi material në shumat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë trajtuar si më poshtë.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatim fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar fiskal është i pasigurt. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat janë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në aktivet dhe detyrimet aktuale ose të shtyra të tatim fitimit në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

Trajtimi i kontratës së koncensionit

Shërbimet e ndërtimit ose të përmirësimit janë njohur në përputhje me kerkesat e IFRS 15 me vlerën e tyre të drejtë. Vlera e drejtë është përllogaritur si shuma që sherbimi i ndertimit do të shitej si një detyrim I pavarur i kontratës së koncensionit. Sic paraqitet ne shenimin **4.9 Trajtimi kontabël per marreveshjen e koçesionit shoqëria ka analizuar kontratën e koncensionit dhe e ka trajtuar atë në përputhje me KIFRN 12 si aktiv afatgjatë jomaterial.**

6. Aktive afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale janë detajuar si më poshtë:

	Toka, troje dhe terrene	Mjete transporti	Pajisje informatike	Mobilje e pajisje zyre	Te tjera	Totali
Kosto						
Gjendja më 1 janar 2020	23,954,762	3,083,000	4,358,728	1,619,905	697,378	33,713,773
Shtesa	-	11,372,251	74,479	213,280	418,810	12,078,820
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**23,954,762**	**14,455,251**	**4,433,207**	**1,833,185**	**1,116,188**	**45,792,593**
Shtesa		892,321,065	1,361,610	312,050	58,113,138	952,107,863
Transferime					20,698,878	20,698,878
Pakësime		(9,926,400)	-	-	-	(9,926,400)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**23,954,762**	**896,849,916**	**5,794,817**	**2,145,235**	**79,928,204**	**1,008,672,934**
Amortizimi i akumuluar						
Gjendja më 1 janar 2020	-	103,048	778,719	149,533	81,317	**1,112,617**
Amortizimi i vitit	-	1,120,440	904,363	299,579	823,297	3,147,679
Pakësime	-	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**-**	**1,223,488**	**1,683,082**	**449,112**	**904,614**	**4,260,296**
Amortizimi i vitit	-	20,307,363	799,088	268,829	4,135,392	25,510,673
Transferime amortizimi					395,579	395,579
Pakësime	-	(1,766,265)	-	-	-	(1,766,265)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**-**	**19,764,587**	**2,482,170**	**717,941**	**5,435,585**	**28,400,283**
Vlera neto kontabël						
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**23,954,762**	**13,231,763**	**2,750,125**	**1,384,073**	**211,574**	**41,532,297**
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**23,954,762**	**877,085,329**	**3,312,647**	**1,427,294**	**74,492,619**	**980,272,651**

7. Aktivet afatgjata jomateriale me koncension

Balanca e aktiveve afatgjata jo-materiale me koncension më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	AAJM	AAJM Process	Totali
Kosto			
Gjendja më 1 janar 2020	1,793,546,534	356,345,612	2,149,892,146
Shtesa	498,929,341	44,288,190	543,217,531
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**2,292,475,875**	**400,633,802**	**2,693,109,677**
Shtesa		2,401,329,904	2,401,329,904
Transferime	962,261,626	(982,592,098)	(20,330,472)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**3,254,737,501**	**1,819,371,608**	**5,074,109,109**
Amortizimi i akumuluar			
Gjendja më 1 janar 2020	46,090,584	-	46,090,584
Amortizimi i vitit	66,626,749		66,626,749
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**112,717,333**	**-**	**112,717,333**
Amortizimi i vitit	84,533,439	-	84,533,439
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**197,250,772**	**-**	**197,250,772**
Vlera neto kontabël			
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**2,179,758,542**	**400,633,802**	**2,580,392,344**
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**3,057,486,728**	**1,819,371,608**	**4,876,858,336**

Aktivet afatgjata jo materiale në lidhje me të drejtat e koçensionit janë përllogaritur në përputhje me vlerësimet e paraqitura në shënimin 5 të këtyre pasqyrave financiare.

8. Aktivet afatgjata jomateriale

Balanca e aktiveve afatgjata jo-materiale më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	AAJM
Kosto	
Gjendja më 1 janar 2020	**295,321**
Shtesa	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**295,321**
Shtesa	-
Transferime	
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**295,321**
Amortizimi i akumuluar	
Gjendja më 1 janar 2020	83,646
Amortizimi i vitit	52,919
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**136,565**
Amortizimi i vitit	**39,689**
Transferime amortizimi	(27,173)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**149,081**
Vlera neto kontabël	
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**158,756**
Gjendja më 31 dhjetor 2021	**146,240**

9. Paradhënie për ndërtime

Paradheniet për ndërtime paraqesin vlerën e parapaguar furnitorëve për aktivitetin e ndërtimit. Shoqëria pret të marrë shërbime për vlerën e mbetur në pasqyrat financiare.

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Materiale të tjera	158,208,319	113,648,496
	158,208,319	**113,648,496**

10. Inventarë

Balanca e inventarëve më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 jepet si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Mallra për shitje	3,626,287	-
Mallra të tjerë	3,288,428	43,428
	6,914,715	**43,428**

11. Llogari të arkëtueshme tregtare

Balanca e Llogari të arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Klientë në euro	4,453,950	983,528
Klientë në lekë	11,295,611	16,060,940
	15,749,561	**17,044,468**

12. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Balanca e llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Llogari të arkëtueshme tregtare nga Kastrati sha	580,066	15,173,111
Financime afatshkurtra Adriatic Bay Investment Group	30,794,184	87,641,872
Llogari të arkëtueshme nga Kastrati Shpk	14,481,000	-
	45,855,250	**102,814,983**

13. Llogari të arkëtueshme të tjera

Balanca e llogari të arkëtueshme të tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Paradhënie për punonjësit	884,915	230,000
TVSH e arkëtueshme	275,310,729	341,481,450
TVSH për tu rregulluar	2,009,338	148,707
Shpenzime të shtyra	208,820	104,410
	278,413,802	**341,964,567**

14. Mjete monetare në arkë dhe bankë

Mjetet dhe ekuivalentët e saj përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Mjete monetare në bankë	**23,450,745**	**9,487,398**
Në Lekë	17,876,902	7,824,438
Në monedhë	5,553,402	1,581,293
Në USD	20,441	81,667
Mjete monetare në arkë	**13,208**	**50,102**
Në Lekë	12,339	49,204
Në monedhë	869	898
Në USD	-	-
	23,463,953	**9,537,500**

15. Kapitali aksionar

Numri dhe vlera nominale e kuotave të regjistruara më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 paraqiten si me poshte:

	31.12.2021		31.12.2020	
	% e kuotave në kapital	Vlera e kapitalit	% e kuotave në kapital	Vlera e kapitalit
Salillari shpk	1%	1	1%	1
Adriatic Bay Investment Group shpk	99%	99	99%	99
	100%	**100**	**100%**	**100**

16. Hua

Huatë afatgjata dhe afatshkurtra më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Kastrati sha	1,661,243,190	1,118,400,800
Adriatic Bay Investment Group	851,112,019	135,000,000
Adriatic Petroleum Platform PTE LTD	191,203,329	247,400,000
Europetrol	28,883,704	27,594,437
Hua afatgjatë Union Bank	773,789,477	-
Hua afatgjatë Tirana Bank	150,950,010	231,937,505
Hua afatgjatë Raiffeisen Bank	113,375,188	287,595,132
AL-GLOBAL OIL SHA	148,000,000	-
Kastrati konstruksion shpk	8,600,000	-
Interesa pasive RZB ASH	785,889	-
	3,927,942,806	**2,047,927,874**

17. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Furnitorë për mallra, produkte dhe shërbime	496,908,034	72,497,268
Furnitorë të tjerë	21,355,368	21,355,368
	518,263,402	**93,852,636**

18. Llogari të tjera ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Kastrati Sha	602,160,120	8,000,000
Europetrol Durrës Albania Sha	586,777,568	-
Shefqet Kastrati	2,083,962	2,083,962
Adriatic Petroleum Platform PTE LTD (ALL)	(5,432)	-
Të tjera të arkëtueshme nga palët e lidhura	7,309,436	582,058,863
	1,198,325,654	**592,142,825**

19. Tatim Fitimi

Detyrim tatim fitimi më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Detyrime per tatimin mbi fitimin	7,454,912	18,460,956
	7,454,912	**18,460,956**

20. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Detyrime për sigurime shoqërore	4,368,500	1,808,478
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat	1,710,982	525,293
Të tjera tatimore	1,993,685	-
Debitorë të tjerë, kreditorë të tjerë	95,135	-
	8,168,302	**2,333,771**

21. Llogari të pagueshme të tjera

Llogaritë e pagueshme të tjera më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Paga të pagueshme	-	401,580
Të tjera të pagueshme	571,142	599,142
	571,142	**1,000,722**

22. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 jepen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020
Te ardhura nga aktivitet e shfrytezimit	663,413,298	565,470,144
Te ardhura nga shitja e mallrave	86,721,434	25,344,168
	750,134,732	**590,814,312**

23. Të ardhura nga aktiviteti i ndërtimit sipas IFRIC12

Të ardhurat nga aktivitetit i ndërtimit njihen në përputhje me vlerën e drejtë siç pasqyrohet në politikat kontabël të shoqërisë. Vlera e drejtë është sa kosto e ndëritmit të objektit të konçensionit të përfshirë në shpenzimet e lëndës së parë dhe materialeve të konsumueshme.
Shuma e të ardhurave nga aktiviteti i ndërtimit është 0 Lek (2020: 528,478,973).

24. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 jepet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020
Shpenzime mirëmbajtje dhe trajtimi	55,988,588	546,414,834
Tarife koncesioni	13,242,601	11,778,698
	69,231,189	**558,193,532**

25. Shpenzime personeli

Shpenzime personeli për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 jepet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020
Shpenzime paga	52,320,905	46,356,570
Shpenzime për sigurime shoqërore	18,438,704	6,982,802
Shpenzim për fond pensioni vullnetar	1,169,500	966,500
	71,929,109	**54,305,872**

26. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzime te tjera te shfrytezimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 jepen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020
Shpenzime uji dhe elektriciteti	25,879,172	7,195,503
Sigurime	730,081	534,330
Karburant	885,580	899,549
Shpenzime të tjera për personelin	9,184,713	3,174,248
Qera	-	114,834
Shpenzime ligjore e konsulenca	20,229,321	2,460,674
Shpenzime pritje dhe përfaqësimi	479,215	196,005
Shpenzime për koncesione, patenta, liçensa dhe të ngjashme	-	40,369
Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	1,093,385	652,773
Komisione dhe tarifa bankare	5,180,930	817,392
Taksa dhe shërbime doganore	3,552,532	958,721
Gjoba e dëmshpërblime	2,181,764	1,415,541
Të tjera shpenzime	10,391,440	4,732,756
Blerje inventar i imet	-	160,669
Sherbime konsulence per kliente	21,546,700	26,025,300
Personel jashtë njesisë	2,220,000	4,382,549
	103,554,833	**53,761,213**

27. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 jepen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Të ardhura nga interesat	(260)	(134)
Shpenzime për interesat	103,960,061	72,880,832
Humbje nga këmbimet valutore	(4,361,300)	15,495,850
Të ardhura nga këmbimet valutore	(28,991,844)	(1,100,554)
	70,606,657	**87,275,994**

28. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 jepet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Fitimi para tatimit	**324,729,144**	**295,929,326**
Total shpenzime të panjohura	**15,208,106**	**9,766,187**
Shpenzime per pritje percjellje		
Penalitete, gjoba e dëmshpërblime	2,181,764	1,415,541
Shitja aktiveve	5,932,542	-
Shpenzime të tjera	7,093,800	8,350,646
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	**339,937,250**	**305,695,513**
Tatim fitimi @15%	50,990,588	45,854,327
	273,738,557	**250,074,999**

Detyrimi për tatim fitimin më 31 dhjetor 2021 është 7,454,912 Lek.

29. Palët e lidhura

Veprimet dhe tepricat me palët e lidhura paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
Gjendje ne fund te vitit		
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	45,855,250	102,814,983
Financime nga palët e lidhura	2,732,442,242	1,528,395,237
Detyrime ndaj paleve te lidhura	1,198,325,654	592,142,825

Veprime gjate vitit	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
Blerje		
Europetrol	382,774,709	102,348,587
Kastrati sha	303,212,024	407,042,532
Te tjera blerje ndaj paleve te lidhura	20,985,871	-
Shitje		
Europetrol	-	-
Kastrati sha	4,862,177	43,668,747
Stafi drejtues	2,220,842	2,231,834

30. Menaxhimi i riskut financiar

Shoqëria është e ekspozuar ndaj risqeve të mëposhtme nga përdorimi prej saj i instrumentave financiarë:

-risku i kreditit
-risku i likuiditetit
-risku i tregut

Ky shënim paraqet informacionin rreth ekspozimit të shoqërisë ndaj secilit prej risqeve të mësipërme, objektivave të shoqërisë, politikave dhe proçeseve për matjen dhe manaximin e riskut dhe manaximin e kapitalit të shoqërisë. Shënime sasiore të tjera janë përfshirë përgjatë këtyre pasqyrave financiare.
Drejtimi ka përgjegjësinë e plotë për hartimin dhe mbikqyrjen e kuadrit të manaximit të riskut të shoqërisë.
Politikat e manaximit të riskut të shoqërisë janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar risqet e hasura nga Shoqëria, për të vendosur kontrollet dhe limitet e duhura të riskut dhe për të monituar riskun dhe respektimin e limiteve. Politikat dhe sistemet e manaximit të riskut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut dhe aktivitetet e shoqërisë. Shoqëria, nëpërmjet trajnimeve dhe standardeve e proçedurave të manaximit të saj, ka si qëllim të zhvillojë një mjedis të disiplinuar dhe konstruktiv të kontrollit në të cilin të gjithë punonjësit janë në dijeni me rolet dhe detyrimet e tyre.
Instrumentat kryesorë financiarë të shoqërisë përbëhen nga mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre, të arkëtueshme dhe të pagueshme dhe të tjera të pagueshme.

30. Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

(a) Risku i kreditit

Vlera kontabël e aktiveve finanicare përfaqëson shumën maksimale të ekspozimit të rrezikut. Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit

(b) Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që kompania të hasë ndonjë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me detyrimet financiare që likuidohen nëpërmjet parave apo aktiveve të tjera financiare.
Qasja e kompanisë për menaxhimin e likuiditetit është të sigurojë, sa më shumë të jetë e mundur, se do të ketë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj, pa pësuar humbje të papranueshme apo rrezikuar dëmtimin e reputacionit të kompanisë.

(c) Risku i normave të interesit

Risku i normës së interesit përfaqëson riskun që vlera e instrumentave financiare do të luhatet nga ndryshimet në treg të normës së interesit dhe riskun që maturiteti i aktiveve financiare që mbartin interes të jetë i ndryshëm nga maturiteti i pasiveve financiare që mbartin interes. Gjatësia e kohës në të cilën norma e interesit është fikse për një instrument financiar përcaktohen se në ç'masë është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit. Aktivet dhe detyrimet e shoqërisë mbajnë normat e interesit të tregut. Në datën e raportit, instrumentat financiarë mbartës të normave të interesit paraqiten nepermjet vleres se huave afatgjata dhe overdrafteve.

31. Angazhime dhe pasiguri

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në menyrë të besueshme.

32. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime kontabël ose shënime shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare.